

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË VENDIM

Kërkesa nr. 24650/15 **FLORESHA KALEMAJ KUNDËR SHQIPËRISË** (*shih tabelën bashkëlidhur*)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 8 shtator 2022, si një Komitet i përbërë nga:

Andreas Zünd, *kryetar*

Darian Pavli,

Frédéric Krenc, *gjyqtarë*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëssekretare e përkohshme e Seksionit*,

duke marrë në konsideratë kërkesën e mësipërme të depozituar më 18 maj 2015,

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Kërkuesja, znj. Floresha Kalemaj, ka lindur në vitin 1962. Ajo u përfaqësua nga znj. I. Harka, një avokate që e ushtron profesionin në Tiranë.

Ankesat e kërkueses bërë në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1, të Protokollit nr. 1 të Konventës, në lidhje me ekzekutimin e vonuar të një vendimi vendas, iu komunikuan Qeverisë Shqiptare ("Qeveria"), procedura për zgjidhje miqësore u vu në lëvizje me anë të zyrës së sekretarit pas komunikimit, ndjekur nga një deklaratë e njëanshme e paraqitur nga Qeveria.

Gjykata nuk mori asnjë përgjigje nga përfaqësuesja e kërkueses brenda afateve të parashikuara.

Me anë të shkresës së dërguar me postë rekomande, përfaqësuesja e kërkueses u njoftua se Gjykata nuk kishte marrë përgjigje brenda afatit të caktuar për paraqitjen e përgjigjes së tij. Në vijim, ajo theksoi nenin 37 § 1 (a) të Konventës, që parashikon se Gjykata mund ta përjashtojë një kërkesë nga lista e çështjeve në rastin kur rrethanat çojnë në përfundimin se kërkuesi nuk ka për qëllim ta ndjekë kërkesën. Shkresa nuk mund të dërgohej, sepse përfaqësuesja kishte ndryshuar adresën dhe nuk kishte njoftuar Sekretarinë për këtë gjë.

LIGJI

Për sa më sipër, në mungesë të korrespondencës nga kërkuesja ose përfaqësuesja e saj për rreth katër vite dhe duke pasur në konsideratë se pas komunikimit të kërkueses me Qeverinë, në Sekretari nuk ishte marrë asnjë shkresë dhe se shkresa më e fundit ishte kthyer në Gjykatë, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi mund të konsiderohet se nuk dëshiron që të ndjekë kërkesat (neni 37 § 1 (a) i Konventës). Gjithashtu, sipas nenit 37 § 1 *in fine*, Gjykata nuk konstaton rrethana të posaçme, në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut sipas parashikimit në Konventë dhe Protokolleve të saj, që kërkojnë shqyrtimin e vazhdueshëm të kërkesës.

Për sa më sipër, është me vend që çështja të përjashtohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos ta përjashtojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 29 shtator 2022.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSSEKRETARE E PËRKOHSHME

Andreas Zünd
KRYETAR

SHTOJCË

KËRKESË QË NGRE ANKESA SIPAS NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS (mosekzekutimi ose ekzekutimi i vonuar i vendimeve vendase)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkueses Viti i lindjes	Emri i përfaqësueses dhe adresa	Ankesa të tjera sipas praktikës gjyqësore të konsoliduar	Data e shkresës së fundit të Gjykatës	Data e përpjekjes për të dorëzuar shkresën e Gjykatës nga Shërbimi i Postës Shqiptare
24650/15 18.5.2015	Floresha KALEMAJ 1962	Iva Harka 1962	Prot. 1, neni 1, ndërhyrje në gëzimin paqësor të pasurive si rezultat i mosekzekutimit të vendimit në favor të kërkuessit	3.2.2022	18.2.2022